



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Indeksi i Çmimeve të Importit TM2 – 2016



P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) gjegjësisht Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare ka filluar të publikojë Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) në qershor 2009. Çmimet e importit filluan të mblidhen në fillim të 2006. Çmimet mblidhen në bazë tremujore dhe mbulojnë kompanitë më reprezentative të importit të cilat ishin aktive në shumicën e komunave për periudhën tremujori i parë 2006 – tremujori i dytë 2016.

Publikimi përmban tabelën e Indeksit të Çmimeve të Importit në Kosovë në bazë tremujore, T1 2006 –T2 2016, mesatarja vjetore për 2006 - 2016 (2010 = 100) me ndryshime tremujore dhe vjetore në përqindje, me prezantim grafikonesh, tabela për pesha, indeksin tremujor për T2 2016, ndryshimet tremujore (T1 2016 –T2 2016) dhe ndryshimet vjetore (T2 2015 –T2 2016) për sektorët sipas Sistemit të Harmonizuar.

IÇIMP është përgatitur në përputhje me standardet dhe metodologjitë evropiane dhe në bashkëpunim me ekspertët nga Statistika e Suedisë dhe Agjencioni Suedez i Zhvillimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA).IÇIMP është në zhvillim e sipër dhe në të ardhmën do të shtohen më shumë vrojtme të çmimeve.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: ekonomik@ks-gov.net

Ky publikim është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha - Drejtori i Departamentit
Ibish Asllani - Shef divizioni
Hamdi Jupolli - Shef Sektori

Shtator, 2016

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,
Isa Krasniqi

Simbolet dhe Shkurtesat

IÇIMP	Indeksi i Çmimeve të Importit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
OBD	Organizata Botrore e Doganave
TM1	Tremujori i parë
TM2	Tremujori i dytë
TM3	Tremujori i tretë
TM4	Tremujori i katërt
:	Shifra nuk është disponibël
0	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	Nuk aplikohet
%	Përqindje
W	Ponderët statistikor (pesha specifike)
∅	Mesatare

Përmbajtja

Faqe

Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP) për TM2 2016.....	4
Tabela 1: Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) TM1 2006 – TM2 2016 (2010 = 100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje.....	5
Figura 1: Zhvillimi i IÇIMP, TM1 2006 – TM2 2016 (2010=100)	6
Tabela 2: Peshat, numrat e Indeksi, ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje sipas sektorëve të Sistemit të Harmonizuar.....	7
Metodologjia	8.9

Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) për tremujorin e dytë 2016

Indeksi i tërsishem i çmimeve të importit në Kosovë u ngrit për 0.7 % në TM2 2016 krahasuar me TM1 2016. Krahasuar me TM2 2015 çmimet e importit pësuan rënie në një mesatare prej -3.9 %.

Tremujori i parë 2016 – Tremujori i dytë 2016 0.7 %

Çmimet e importit në Kosovë u ngriten në një mesatare prej 0.7 % në TM2 2016 krahasuar me TM1 2016. Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te produktet minerale (5.8 %), shtazet e gjalla; produktet e shtazëve (3.2 %), metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (1.9 %), artikujt ushqimor të përgaditur, pijet dhe duhani (0.8 %), letrat dhe artikujt e saj (0.5 %), druri dhe artikujt e tij (0.2 %) dhe lekura dhe artikujt e saj (0.1 %).

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektoreve te produktet bimore (-3.7 %), vajrat ushqyese (-3.5 %), tekstili dhe artikujt e tekstilit (-3.4 %), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-1.6 %), këpuçet (-1.4 %), artikujt e ndryshem të prodhuar (-0.7 %), instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e ores (-0.5 %), paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (-0.4 %) dhe produktet e industrive kimike (-0.4 %).

Tremujori i dytë 2015 – Tremujori i dytë 2016 -3.9 %

Çmimet e Importit në Kosovë pësuan rënie në një mesatare prej -3.9 % në mes TM2 2015 dhe TM2 2016. Rënie më të mëdha sipas sektorëve ishin te produktet minerale (-17.3 %), metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-7.0 %), shtazet e gjalla; produktet e shtazëve (-5.7 %), tekstili dhe artikujt e tekstilit (-3.6 %), paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (-2.4 %), artikujt e gurit, llaçit, produktet e keramikës dhe të qelqit (-1.3 %), mjetet e transportit (-0.4 %), instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e ores (-0.3 %) dhe artikujt e ndryshem të prodhuar (-0.2 %).

Rënia u neutralizua kryesisht nga ngritja e çmimeve sipas sektoreve te vajrat ushqyese (7.9 %), produktet bimore (4.7 %), druri dhe artikujt e drurit (3.1 %), produktet e industrive kimike (1.2 %), këpuçet (0.6 %), artikujt ushqimor të përgaditur, pijet dhe duhani (0.4 %), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (0.1 %) dhe letrat dhe artikujt e saj (0.1 %).

Tabela 1: Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) TM1 2006–TM2 2016 (2010 = 100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje

Viti	Tremujori	Indeksi (2010 = 100)	Ndryshimi tremujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje
2006	TM 1	86.2	:	:
	TM 2	88.7	2.9	:
	TM 3	89.1	0.5	:
	TM 4	87.7	-1.6	:
	Mesatarja vjetore 2006	87.9	:	:
2007	TM 1	89.4	1.9	3.7
	TM 2	92.1	3.1	3.9
	TM 3	91.1	-1.1	2.2
	TM 4	91.6	0.6	4.5
	Mesatarja vjetore 2007	91.1	:	3.6
2008	TM 1	95.0	3.6	6.3
	TM 2	100.9	6.2	9.5
	TM 3	102.5	1.6	12.5
	TM 4	96.9	-5.4	5.8
	Mesatarja vjetore 2008	98.8	:	8.5
2009	TM 1	93.7	-3.3	-1.3
	TM 2	94.2	0.5	-6.6
	TM 3	94.0	-0.2	-8.3
	TM 4	94.3	0.4	-2.7
	Mesatarja vjetore 2009	94.1	:	-4.8
2010	TM 1	95.7	1.5	2.1
	TM 2	99.0	3.4	5.1
	TM 3	101.4	2.5	7.9
	TM 4	103.9	2.5	10.2
	Mesatarja vjetore 2010	100.0	:	6.3
2011	TM 1	107.8	3.7	12.6
	TM 2	108.4	0.5	9.5
	TM 3	109.9	1.4	8.3
	TM 4	111.0	1.0	6.8
	Mesatarja vjetore 2011	109.3	:	9.3
2012	TM 1	113.9	2.6	5.6
	TM 2	114.9	0.9	6.0
	TM 3	115.4	0.5	5.0
	TM 4	115.8	0.3	4.3
	Mesatarja vjetore 2012	115.0	:	5.2
2013	TM 1	116.1	0.3	2.0
	TM 2	115.0	-1.0	0.1
	TM 3	114.8	-0.1	-0.5
	TM 4	114.8	0.0	-0.8
	Mesatarja vjetore 2013	115.2	:	0.2
2014	TM 1	115.5	0.6	-0.6
	TM 2	114.3	-1.0	-0.6
	TM 3	114.8	0.5	0.0
	TM 4	114.4	-0.4	-0.3
	Mesatarja vjetore 2014	114.7	:	-0.4
2015	TM 1	113.8	-0.5	-1.4
	TM 2	114.1	0.3	-0.2
	TM 3	113.9	-0.2	-0.8
	TM 4	111.8	-1.8	-2.3
	Mesatarja vjetore 2015	113.4	:	-1.2
2016	TM 1	108.8	-2.6	-4.4
	TM 2	109.6	0.7	-3.9

Figura 1: Zhvillimi i IÇIMP, TM1 2006 – TM2 2016 (2010=100)




Tabela 2: Peshat, numrat e Indeksi, ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje sipas sektorëve të Sistemit të Harmonizuar

Kodi	Grupi	pesha	TM2 - 2016 2010 =100	TM2 - 2016 TM1 - 2016	TM2 - 2016 TM2 - 2015
01-21	IÇIMP - Gjithsej	1000	109.6	0.7	-3.9
01	Shtazët e gjalla; produktet e shtazëve	42	118.9	3.2	-5.7
02	Produktet bimore	54	155.7	-3.7	4.7
03	Vajrat ushqyese	10	151.8	-3.5	7.9
04	Artikuj ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani	135	111.8	0.8	0.4
05	Produktet minerale	155	98.3	5.8	-17.3
06	Produktet e industrive kimike	85	108.4	-0.4	1.2
07	Plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre	63	109.7	-1.6	0.1
08	Lëkura dhe artikujt e saj	2	100.8	0.1	:
09	Druri dhe artikujt e tij	24	121.8	0.2	3.1
10	Letrat dhe artikujt e saj	14	114.5	0.5	0.1
11	Tekstili dhe artikujt e tekstit	40	108.5	-3.4	-3.6
12	Këpucët	12	153.2	-1.4	0.6
13	Artikujt e gurit, të llaçit, produktet e keramikës dhe te qelqit	40	107.5	0.0	-1.3
14	Margaritarët, gurët e çmuar, metalet, etj.	:	:	:	:
15	Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë	99	89.4	1.9	-7.0
16	Paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike	119	108.6	-0.4	-2.4
17	Mjetet e transportit	63	110.0	0.0	-0.4
18	Instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës	12	107.7	-0.5	-0.3
19	Armët dhe municioni	:	:	:	:
20	Artikujt e ndryshëm të prodhuar	30	114.2	-0.7	-0.2
21	Veprat e artit	:	:	:	:

Metodologjia

Çmimet grumbullohen në bazë tremujore në 7 qendra regjionale të Kosovës: Gjakovë, Gjiilan Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj të cilat mbulojnë kompanitë më reprezentative të importit të cilat ishin aktive në shumicën e komunave.

Duke filluar nga tremujori i parë 2006, çmimet u grumbulluan në bazë tremujore për rreth 180 artikujt nga shtatëdhjetë kompani. Gjatë 2006 shumë vlerësime të reja të çmimeve u shtuan dhe për periudhën 2007-2008 numri i çmimeve të grumbulluara ishte rreth 250. Nga 2009 numri i çmimeve të grumbulluara ishte rreth 300, kurse nga viti 2015 numri i çmimeve është mbi 500 artikuj.

Rezultatet janë prezentuar sipas Sistemit të Harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganeve (OBD).

Të dhënat e çmimeve janë grumbulluar për një mostër të transaksioneve tipike lidhur me mallrat e importuara në Kosovë

Mostrimi dhe kalkulimi i peshave

Mostra është projektuar nga të dhënat e tregëtisë së jashtme. Këto të dhëna janë përdorur gjithashtu edhe për kalkulimin e peshave specifike. Peshat janë bazuar në informatën nga të dhënat tregëtare V-1 (viti paraprak) dhe janë freskuar në bazë vjetore. Me anë të freskimit të peshave për çdo vit, shporta e IÇIM-së do të reflektojë ndryshimet në mostrat e tregëtisë. IÇIM-ja do të ndikohet nga të dyja ndryshimet e çmimeve dhe nga ndryshimet e strukture së importit

Variablët statistikor

Variabli kryesor është çmimi; ai mund të raportohet në çdo njësi monetare. Çmimet e raportuara në njësi të huaja monetare konvertohen në EURO. Njësia monetare e faturës dhe raportimit janë, prandaj si variabël plotësues. Kur çmimet raportohen në njësi të huaja monetare, atëherë përdoren tarifatat e këmbimit të mesatarës tremujore të Bankës Qendrore Suedeze për konvertimin e tyre në EURO.

Formulat e indeksit

Indeksi i çmimeve të importit mund të përshkruhet si një indeks i llojit zinxhiror të Laspeyres-it me lidhje vjetore. Indeksi i Laspeyres-it definohet si në vijim.

$$I^t = \frac{\sum_{i=1}^n P_i^t Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} = \sum_{i=1}^n \frac{P_i^0 Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} \times \frac{P_i^t}{P_i^0}$$

Ku P^0 dhe P^t janë çmimet për njësi në periodën bazë (0) dhe perioda e krahasimit (t), përkatësisht, dhe Q^0 është sasia e periodës bazë. Mbledhja bëhet nëpërmes produkteve n. Në elementin qendror të mësipërm, indeksi shprehet me shkallën mes vlerës së mbledhur të shumave të periodës bazë në periodën e krahasimit dhe në nivelin e çmimit të periodës bazë, përkatësisht. Indeksi gjithashtu mund të shprehet, si në elementin final, si një mesatare e përafërt e çmimit të mallërave të peshuar me vlerat e periodës.

Çmimet e indeksit kalkuloohen me një tremujor aktual në vit si periudhë e krahasimit dhe me tremujorin e katërt në vitin **y-1** si period e references së çmimit. Perioda e peshimit është viti **y-1**. Në këtë mënyrë lidhja definohet si:

$$I_{y-1,q}^{y,q} = \sum_{s=1}^k \frac{V_s}{\sum_{s=1}^k V_s} \times \frac{P_s^{y,q}}{P_s^{y-1,q}}$$

Ku pasha e vlerës V_s është vlera e transakcioneve në vit e që përfaqësohen me specifikacionin **s**. Mbledhja bëhet nëpërmes specifikacioneve **k**.

Kalkulimi i indeksit zinxhiror të IÇIMP

Numri i indeksit zinxhiror kalkulohet për tremujorët dhe tregon nivelin e veçantë të çmimit të tremujorit krahasuar me nivelin e çmimit mesatar në 2010 (2010=100).

$$I_{2010}^{y,q} = \frac{100}{\frac{1}{4} \sum_{q=1}^4 I_{2009,q}^{2010,q}} \times \prod_{Y=2010}^{y-1} I_{Y-1,q}^{Y,q} \times I_{y-1,q}^{y,q}$$

Kalkulimi i ndryshimeve

Ndryshimi tremujor kalkulohet si:

$$\left[\left(\frac{IMPI_0^{Y,q}}{IMPI_0^{Y,q-1}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshim i përqindjes tremujore}$$

$IMPI_0^{Y,q}$ = Indeksi i çmimeve të importit për tremujorin aktual q

$IMPI_0^{Y,q-1}$ = Indeksi i çmimeve të importit për tremujorin e mëparshëm q-1

Ndryshimi vjetor kalkulohet si:

$$\left[\left(\frac{IMPI_{2010}^{Y,q}}{IMPI_{2010}^{Y-1,q}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshim i përqindjes vjetore}$$

$IMPI_{2010}^{Y,q}$ = Indeksi zinxhiror i çmimeve të importit për tremujorin aktual q

$IMPI_{2010}^{Y-1,q}$ = Indeksi zinxhiror i çmimeve të importit për vitin dhe për tremujorin paraprak q

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse; (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>